



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:259186

Datë: 27.11.2024

Numri i dokumentit: 06519631

K.DH.SH.II.nr.1339/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtarin Krenar Berisha në çështjen përmbartimore të kreditorit “Beghler Talo” Sh.P.K., me numër unik identifikues 811866948, me seli në Prizren, fshati Lubizhde, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Liman Musa, avokat nga Ferizaj, kundër debitorit “Beghler” L.L.C., me numër unik identifikues 810974081, me seli në Prizren, fshati Lubizhde, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson zyra e avokatisë “Themis” Sh.P.K., me seli në Prizren, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale-Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.2011/23 të datës 28.05.2024, me datë 27.11.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e kreditorit Beghler Talo Sh.P.K., me numër unik identifikues 811866948, me seli në Prizren, fshati Lubizhde, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale- Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.2011/23 i datës 28.05.2024, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.2011/23 të datës 28.05.2024, e ka pranuar si të bazuar

prapësimin e debitorit Beghler” L.L.C., ndërsa Urdhri Përmbarimor P.nr.369/23 i datës 31.10.2023, i lejuar nga Përmbaruesi Privat Argjent Xheladini, është anuluar.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave procedurale, dhe konstatimit të gabuar dhe jo të drejtë të gjendjes faktike, me propozim që gjykata të aprovoj ankesën e kreditorit dhe aktvendimi i atakuar të ndryshohet, ose të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje në shkallë të parë.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

- Ankesa e kreditorit është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se Përmbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Beghler Talo” Sh.P.K., me datë 31.10.2023 ka lëshuar urdhrin përmbarimor P.nr.369/23, duke lejuar përmbarimin mbi bazën e dokumentit të besueshëm- Faturës nr.250, e datës 13.12.2022, duke detyruar debitorin “Beghler” L.L.C., që në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit të këtij urdhri në emër të borxhit nga fatura e lartcekur t’ia paguaj kreditorit shumën e përgjithshme prej 10,311.50, me kamatë ligjore prej 8 % e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore.

Debitori, përmes përfaqësuesit të autorizuar brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim me të cilin ka kundërshtuar urdhrin përmbarimor me arsyetim se urdhri për lejimin e përmbarimit është marrë në kundërshtim me nenin 71, pika 1.1 të LPP-së, për arsye se detyrimi i përcaktuar nuk ekziston dhe nuk është bërë i arritshëm, ndërsa dokumentet me të cilat është lejuar përmbarimi nuk përmbajnë tipare të përmbarueshmërisë. Më tej ka theksuar se faturës i mungojnë të dhënat e kreditorit dhe debitorit, nuk është paraparë koha e pagesës, si dhe e njëjta paraqet vetëm regjistrimin e mallrave në depot doganore të palëve në procedurë dhe jo qarkullim të rregullt në mes të subjekteve. Për këto arsye, i ka propozuar gjykatës që të aprovojë prapësimin e debitorit, ndërsa urdhri përmbarimor të anulohet.

Kreditori, përmes përfaqësuesit të autorizuar në përgjigje ndaj prapësimit ka kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit për arsye se me asnjë provë nuk ka mbështetur të njëjtat dhe se qëllimi i tij është vonesa dhe shtyerja e përmbarimit duke krijuar rrethana të pa qena për të mos paguar detyrimet ndaj kreditorit. Ka shtuar se debitori ka qenë i obliguar që t'ia paguajë kreditorit shumën sipas faturës, e ku konfirmohet pranimi i mallit përmes nënshkrimit dhe vulosjes, ashtu që fatura është paraqitur në origjinal, është nënshkruar dhe vulosur. I ka propozuar gjykatës që të refuzojë prapësimin e debitorit si të pa bazuar, ndërsa urdhri përmbarimor të mbetet në fuqi.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar KPPP.nr.2011/23 të datës 28.05.2023, me të cilin e ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit Beghler” L.L.C., ndërsa Urdhri Përmbarimor P.nr.369/23 i datës 31.10.2023, i lejuar nga Përmbaruesi Privat Arxhent Xheladini, është anuluar.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka theksuar se Fatura nr.250, e datës 13.12.2022, në bazë të së cilës është lejuar përmbarimi nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, përkatësisht nuk është evidentuar saktë kreditori me të dhënat e tij, e po ashtu nuk evidentohet as pala debitorë dhe të dhënat përcjellëse të tij, elemente komulative që kërkohet sipas nenit 29.3 të LPP-së.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbarimore kur e ka aprovuar prapësimin e debitorit, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës qartë konstatohet se përmbarimi është lejuar në bazë të dokumentit të besueshëm Faturës nr. 250, të datës 13.12.2022, e lëshuar nga kreditori, e cila nuk përmban elementet që kërkohen me nenin 29 par.3 të LPP-së në të cilin parashihet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*. Nga kjo dispozitë ligjore rrjedh se për ta caktuar përmbarimin në bazë të dokumentit të besueshëm ai duhet të jetë i hartuar në formën e kërkuar ligjore, megjithatë në rastin konkret nuk janë përmbushur këto kërkesa, pasi në dokumentin e besueshëm Faturën nr.250, të datës 13.12.2022 mungon emri i debitorit dhe numri i biznesit të tij si dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar, qoftë në formë të datës së caktuar qoftë në formë të afatit, andaj gjykata e shkallës së

dytë vlerëson se si rezultat i mungesës së emrit të debitorit, numrit të biznesit të tij dhe kohës së përmbushjes së detyrimit monetar në dokumentin e besueshëm, vie deri te mungesa e tipareve të përmbarueshmërisë së dokumentit të besueshëm, ku për pasojë duhet të zbatohet neni 71 par.1 nënpar. 1.1 të LPP-së, sipas të cilit “(..) prapësimi mund të bazohen vetëm nëse dokumenti, në bazë të cilit është marr vendimi përmbarues ose urdhri përmbarues, nuk ka titull ekzekutiv ose nuk ka tipare të përmbarueshmërisë”.

Gjykata e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim në pajtim me dispozitat ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe gjykata e shkallës së dytë, me çka mbi bazën e këtyre rrethanave dhe fakteve të kësaj gjykate rezulton se aktvendimi i ankimuar i nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë është i drejtë dhe i bazuar.

Gjykata Komerciale - Dhoma e Shkallës së Dytë me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe pretendimet ankimore të kreditorit, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Përndryshe, në procedurën përmbarimore, nën parimin e rigorozitetit formal, bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbarimin.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e shkallës së dytë

K.DH.SH.II.nr.1339/24, me datë 27.11.2024

Gjyqtari,
Krenar Berisha